

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 KUVENDI
 Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 10/11/2025

Lënda: Kërkesë për rikthimin e një ligji për rishqyrtim.

Drejtuar: **Z. Bajram BEGAJ**
President i Republikës së Shqipërisë

Z. President i Republikës,

Kuvendi i Shqipërisë në seancën e datës 6 Nëntor 2025 ka miratuar vetëm me votat e mazhorancës projektligjin “Për barazinë gjinore”, i cili prek thelbin e familjes shqiptare dhe përmban përcaktime që qartazi cenojnë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ne, zonjat deputete, kërkojmë nga Presidenti i Republikës, që pasi të shqyrtojë me vëmendje ligjin e miratuar nga Kuvendi, të ushtrojë kompetencën e tij kushtetuese, parashikuar nga pika 1, neni 85 të Kushtetutës, ku sanksionohet se: “*Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë*”. Në këtë drejtim, kërkojmë nga Presidenti i Republikës që të mbajë në konsideratë opinionin e ekspertëve konstitucionalist që kanë kundërshtuar miratimin e këtij ligji, si dhe të organizatave të shoqërisë civile “Pro Familjes” që kanë ngritur shqetësime serioze mbi përmbajen e ligjit.

Z. President,

Në çdo shtet të së drejtës, ligji ekziston për të mbrojtur qytetarin nga padrejtësia, jo për ta vënë atë nën diktatin e ideologjive kalimtare. Ligji është mburoja e lirisë përballë pushtetit, garancia e dinjitetit njerëzor përballë arbitraritetit. Siç paralajmëronte Montesquieu, “*kur ligji bëhet mjet për t'i detyruar njerëzit të mendojnë njësoj, ai pushon së qenë ligj dhe bëhet instrument tiranie*.” Fatkeqësisht, ky është pikërisht rreziku që po troket sot në derën e shtetit shqiptar përmes miratimit të ligjit “Për barazinë gjinore”.

Ligji “Për Barazinë Gjinore”, i miratuar nën petkun e përafrimit me aktet e Bashkimit Evropian, në thelb nuk është as përafrim dhe as instrument mbrojtës ndaj diskriminimit. Nëse ju do të analizoni vetë direktivat e Bashkimit Evropian të përmendura në relacionin shoqërues, do të konstatonin një fakt të qartë: asnjë prej tyre nuk përmend “identitete gjinore”, “shprehje gjinore” apo “përkatësi të shumëfishta.” Asnjë.

Përkundrazi, shtatë nga dhjetë direktivat e BE-së që citohen në fund të vetë projektligjit, e kanë që në titull konceptin binar dhe natyror të “grave dhe burrave.” E drejta e Bashkimit Evropian në këtë fushë është ndërtuar mbi një parim të vetëm dhe të pandryshueshëm: barazinë ndërmjet grave dhe burrave. Ky është standardi evropian, i vetmi i pranuar dhe juridikisht i harmonizuar në të gjitha shtetet anëtare.

Në këtë dritë, ligji i miratuar nga Kuvendi nuk përbën “harmonizim” me të drejtën e BE-së, por devijim prej saj. Ai nuk synon realisht mbrojtjen e grave, burrave apo individëve nga diskriminimi i padrejtë, por hap rrugën për imponimin e një ideologjie që mohon realitetin biologjik, relativizon

kuptimin e gjinisë, dhe krijon një terren të rrezikshëm për censurë ligjore dhe kufizim të lirive themelore të mendimit, fesë dhe shprehjes.

Problemi i vërtetë i ligjit nuk kufizohet vetëm në mënyrën si do të përkufizohen termi “gjini” apo termi “Përkatësi e shumëfishtë”. Problemi qëndron në faktin se pas çdo përmendjeje të fjalës “gjini”, ligji shoqërohet në mënyrë të përsëritur me togfjalëshin “për shkak të përkatësisë së shumëfishtë gjinore” dhe me shprehjen “në të gjithë diversitetin e tyre.” Dhe këtë e bën dhjetëra herë në përmbajtjen e ligjit, në kontekste nga më të ndryshmet. Në këtë mënyrë, ligji nuk ndalet më tek koncepti juridik dhe biologjik i gjinisë, sado mirë të jetë perkufizuar në ligj, por shtrihet përtej tij, duke njohur edhe “përkatësinë e shumëfishtë gjinore” apo “gjinitë në gjithë diversitetin e tyre,” pra duke e zëvendësuar realitetin natyror binar të grave dhe burrave me një kuadër të pafundësisht të hapur, pa përkufizim juridik dhe pa mbështetje kushtetuese.

Këto formulime, të paqarta në përmbajtje dhe të huaja për rendin tonë juridik, hapin derën për interpretime të pakufizuara, që mund të cenojnë vetë konceptin kushtetues të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, si dhe të krijojnë pasiguri në zbatimin e ligjit në fusha si arsimi, sporti, shëndetësia dhe liria e besimit.

Ky është pikërisht edhe argumenti që në vitin 2016 çoi Gjykatën Kushtetuese të Francës (Conseil Constitutionnel) të marrë një vendim të prerë kundër njohjes ligjore të “gjinisë neutrale” dhe të “identiteteve të shumëfishta gjinore.” Në vendimin e saj, Gjykata më e lartë franceze theksoi se një veprim i tillë do të cënonte parimin e sigurisë juridike, barazinë përpara ligjit dhe unitetin e identitetit civil të qytetarëve, i cili në rendin juridik francez mbështetet mbi binaritetin biologjik “burrë” dhe “grua.” Sipas arsytimit të Gjykatës, çdo devijim nga kjo strukturë do të sillte pasiguri juridike në regjistrat civilë, paqartësi në të drejtën familjare dhe vështirësi në zbatimin e normave penale, administrative dhe shëndetësore. Ky vendim përbën sot një precedent të rëndësishëm në Europë, që tregon qartë se respektimi i dinjitetit njerëzor dhe barazisë gjinore nuk mund të arrihet duke mohuar realitetin biologjik mbi të cilin janë ndërtuar rendet kushtetuese të shteteve demokratike.

Për këtë arsye, është thelbësore që këto togfjalësha: “për shkak të përkatësisë së shumëfishtë gjinore” dhe “në të gjithë diversitetin e tyre”, duhet të ishin hiqur plotësisht nga ligji, në përputhje me detyrimet që përcaktojnë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Familjes dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet që ligji i ri të mos bëhet mjet ideologjik, por të mbetet garanci juridike e barazisë reale ndërmjet grave dhe burrave, në përputhje me traditën kushtetuese, parimet e së drejtës evropiane dhe me vlerat themelore të lirisë mbi të cilat mbështeten të gjitha demokracitë e vërteta.

Në gjendjen që është miratuar ligji “Për Barazinë Gjinore”, i paraqitur si hap drejt “harmonizimit me Bashkimin European”, në fakt nuk është as harmonizim dhe as mbrojtje nga diskriminimi. Ai nuk synon mbrojtjen e grave, burrave apo personave me orientim seksual të ndryshëm nga diskriminimi i vërtetë, por imponimin e një ideologjie që mohon natyralitetin biologjik binar, vendos censurë ligjore dhe shkel parimet themelore të rendit kushtetues.

Më poshtë po rendisim vetëm disa nga pasojat që do të sillte hyrja në fuqi e këtij ligji, në rendin juridik shqiptar.

I. Cënimet ndaj Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Ligji “Për Barazinë Gjinore” nuk bie ndesh vetëm me të drejtën e BE-së, por bie ndesh haptazi edhe me vetë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Përmbajtja e këtij ligji nuk është një përparim në drejtim të të drejtave të njeriut, por një devijim i qartë nga fryma dhe gërma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në thelb, ai përpiqet të zëvendësojë rendin juridik të bazuar në realitetin biologjik dhe moral të njohur në Kushtetutë, me një sistem normash që burojnë nga një ideologji e imponuar. Kjo përbën një rrezik të drejtpërdrejtë për vetë themelet e shtetit të së drejtës.

Së pari, neni 18 i Kushtetutës garanton barazinë para ligjit “pa dallim gjinie”, duke iu referuar qartësisht dy gjinive biologjike, mashkull dhe femër, që janë themeli i rendit natyror dhe juridik të shtetit. Ligji, duke futur koncepte si “identitete të shumëfishta gjinore” apo “përkatësi e ndërthurur”, tejkalon kuadrin kushtetues dhe krijon një kategori të re ligjore që nuk ekziston në tekstin themelor të Republikës. Kështu, ai jo vetëm shtrembëron frymën e nenit 18, por tenton të rishkruajë antropologjinë njerëzore përmes ligjit.

Së dyti, neni 22 i Kushtetutës, që mbron lirinë e shprehjes dhe të shtypit, bie ndesh me dispozitat e ligjit që sanksionojnë fjalën ndryshe. Kriminalizimi, ndëshkimi administrativ, apo njohja e dëmshpëtlimit civil të sanksionuara në këtë ligj, ndaj çdo qëndrimi që nuk përputhet me doktrinën e “identitetit gjinor” kthehet në një formë censure të institucionalizuar, e cila ndalon debatin, kërkimin shkencor dhe kritikën morale apo fetare. Një ligj që ndëshkon fjalën, për nga natyra, është një ligj që ndëshkon mendimin dhe ndërgjegjen, pra e shkel vetë frymën e demokracisë.

Së treti, neni 24 i Kushtetutës, që garanton lirinë e ndërgjegjes, mendimit dhe besimit fetar, është në rrezik të drejtpërdrejtë nga ky ligj. Nëse një imam, prift, apo qytetar besimtar shprehet sipas parimeve të tij fetare, për shembull, duke thënë se Zoti krijoi mashkullin dhe femrën, dhe nuk njeh identitetet subjektive gjinore të shumëfishta, ai rrezikon të gjobitet apo të ndëshkohet për “diskriminim gjinor”, apo ndaj tij të paraqiten padi civile për dëmshpërblim. Ky skenar absurd do të thotë se shteti, në vend që të garantojë pluralizmin moral, të mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, po imponon një “fe” të re ideologjike që nuk pranon as kundërshti, as debat, as besim fetar, por vetëm nënshtrim pa pasur as shancin për ta kundërshtuar. Sjellim në vëmendjen tuaj se të gjitha Komunitetet Fetare në Shqipëri kanë kundërshtuar publikisht ligjin e miratuar.

Së katërti, neni 54 i Kushtetutës njeh prindërve të drejtën për t’u siguruar fëmijëve të tyre edukim moral dhe fetar në përputhje me bindjet e tyre. Futja e “edukimit gjinor” me përmbajtje që promovon koncepte të shumëfishta identitare, jo vetëm pa pëlqimin e prindërve, por edhe në kundërshtim me vlerat e tyre, përbën cënim të drejtpërdrejtë të autoritetit prindëror dhe të autonomisë familjare. Shteti, në këtë mënyrë, hyn në një fushë që nuk i përket, ndërgjegjen e fëmijëve dhe drejtimin moral të familjes.

Në thelb, ky ligj përmbys ekuilibrin themelor midis lirisë dhe detyrimit. Ai e zëvendëson lirinë e ndërgjegjes me imponim ideologjik, fjalën e lirë me frikë, dhe bindjen morale me konformitet të detyruar. Përmes terminologjisë së turbullt si “identitet gjinor”, “përkatësi e shumëfishtë” dhe “ndërthurje sociale”, ky ligj tenton të rishkruajë vetë përkufizimin e njeriut, duke e kthyer biologjinë në çështje opinioni dhe ndjenjën personale në burim detyrimi ligjor.

Për këto arsye, kjo nuk është më barazi. Kjo është një formë e re e imponimit përmes ligjit, ku shteti nuk e mbron qytetarin nga padrejtësia, por e ndëshkon nëse guxon të mendojë ndryshe. Dhe kur ligji kthehet në doktrinë, siç thoshte juristi i famshëm gjerman Gustav Radbruch, “*drejtësia vdes dhe mbetet vetëm fuqia e zhveshur e pushtetit*.”

II. *Mospërputhja me të drejtën e Bashkimit European*

Pretendimi se ligji “Për Barazinë Gjimore” është një kërkesë e domosdoshme për “përafrim me Bashkimin European” nuk ka asnjë bazë juridike, dhe është një gënjeshtër që po i bëhet publikut shqiptar, medias shqiptare, madje vete deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Ripërërsim se, asnjë direktivë e Bashkimit European nuk përmend “identitete gjimore”, “përkatësi të shumëfishta” apo “transgjimore” si kategori juridike, e aq më pak të detyruara për shtetet anëtare.

Direktivat e vërteta që formojnë bërthamën e së drejtës europiane për barazinë gjimore, si Direktiva 79/7/KEE, Direktiva 2006/54/KE, Direktiva 2004/113/KE dhe më e fundit Direktiva 2023/970/BE, janë të gjitha të ndërtuara mbi parimin e barazisë midis burrave dhe grave, pa asnjë referencë ndaj nocioneve ideologjike të “gjinisë së vetëpërzjetuar” apo “identitetit jo-binar”. Vetë Bashkimi European, përmes traktateve themelore dhe praktikës së tij gjyqësore, ka mbajtur një qasje të kujdesshme, duke i lënë shtetet anëtare të përcaktojnë vetë se si trajtohen çështjet që lidhen me përkufizimin ligjor të gjinisë.

Në këtë kuadër, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit European (GJED) ka qenë e qartë. Në çështjen *C-423/04 Richards*, ajo theksoi se përcaktimi i kushteve për njohjen e ndryshimit të gjinisë është kompetencë e shteteve anëtare, jo një detyrim që buron nga e drejta e Bashkimit. Me fjalë të tjera, BE-ja nuk imponon uniformitet në çështjet e identitetit gjinor, dhe çdo shtet ruan të drejtën e vet sovranë për të përcaktuar se çfarë nënkupton gjinia në rendin e tij juridik.

Dhe në fakt, provat flasin vetë: 21 nga 27 shtetet anëtare të Bashkimit European njohin vetëm identitetin binar gjinor, mashkull dhe femër, si kategori ligjore. Pra edhe në nivel individual të shteteve anëtare të BE-së, realiteti ligjor brenda vetë tyre është i qartë dhe i pamohueshëm: shumica dërrmuese e vendeve anëtare, njohin vetëm identitetin binar gjinor, pra ndarjen natyrore dhe juridike midis burrit dhe gruas. Vetëm një pakicë shumë e kufizuar shtetesh, si Gjermania, Malta, dhe Holanda, kanë futur në mënyrë eksperimentale një kategori të “tretë” ose “neutrale”, e cila mbetet e debatueshme, jo e standardizuar dhe dhe shpesh e kontestuar brenda vetë sistemeve të tyre kushtetuese dhe gjyqësore. Modeli i paqartë i miratuar me ligjin “Për barazinë gjimore” rezulton se është shumë më ekstremisht ideologjik edhe se legjislacionet e këtyre vendeve.

Ndërkohë, 21 shtete të tjera, si Franca, Italia, Greqia, Spanja, Polonia, Hungaria, Austria, Kroacia, Sllovakia, Rumania, Bullgaria, Portugalia, etj, e kanë refuzuar qartësisht ligjërimin e “identiteteve gjimore jo-binare”, duke mbajtur qëndrimin se gjinia është kategori biologjike, ligjore dhe e pandryshueshme për efekt civil.

Ky realitet faktik dhe juridik tregon se nuk ekziston asnjë standart i detyrueshëm evropian për njohjen e “identiteteve të shumëfishta gjimore”, dhe se çdo përpjekje për t’i imponuar këto koncepte Shqipërisë në emër të “harmonizimit me BE-në” është juridikisht i pasaktë dhe politikisht mashtruese. Në të vërtetë, e drejta e BE-së, dhe ligjet e vendeve anëtare të BE-së janë binare. Ato mbrojnë individin nga diskriminimi real, në punë, në paga, në arsim, por nuk ndërhyjnë në biologji dhe as në ndërgjegje. Ajo kërkon drejtësi, jo riformatim antropologjik. Siç ka thënë filozofi i famshëm gjerman Immanuel Kant, “*Liria përfundon aty ku fillon imponimi i mendimit të tjetrit*”.

Në këtë drejtim, miratimi i një ligji që imponon terminologjinë e “identiteteve të shumëfishta gjinore” në Shqipëri nuk është përafrim me Bashkimin Evropian, por devijim prej tij. Shqipëria rrezikon të krijojë një kornizë ligjore që asnjë vend anëtar nuk e ka, duke futur në sistemin e vet një element ideologjik që nuk gjen as precedent Evropian, dhe do të përbënte një eksperiment të madh social dhe juridik në Shqipëri, që mund të paralelizohet vetëm me Kushtetutën e 1976-ës, që ndaloi lirinë e besimit dhe ndërgjegjes, dhe shpalli si të vetmen ideologji të pranueshme atë ateisto-materialiste, dhe duke dënuar çdo ideologji që nuk përputhej me të.

Në fund, duhet kujtuar ajo që ka theksuar vetë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*çështja Goodëin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2002): liritë dhe barazia duhet të interpretohen në dritën e “nevojës për ruajtjen e rendit moral dhe të drejtës natyrore në një shoqëri demokratike”. Nëse Shqipëria vendos të heqë dorë nga ky parim themelor, ajo nuk do të afrohet më pranë BE-së, por do të largohet prej saj, duke ndërtuar një sistem që i ngjan më shumë Shqipërisë atiesto-komuniste, se sa shtetit të së drejtës.

III. *Mospërputhja me rendin ligjor aktual shqiptar*

Në themel të rendit juridik shqiptar, janë Kodet e ndryshme ligjore që rregullojnë në mënyrë të kodifikuar dhe organizar marrëdhëniet në cdo fushë specifike. Kodi i Familjes, është pa dyshim një ndër ligjet më të ndjeshme dhe më të ngulitura në strukturën morale dhe kulturore të shoqërisë. Ky Kod, në nenin 7 përcakton qartësisht se martesë dhe familja bazohen në bashkimin midis burrit dhe gruas, duke njohur si shtyllë juridike dhe morale realitetin biologjik mbi të cilin ndërtohet jeta shoqërore. Çdo përpjekje për ta zëvendësuar termin “gjinia” me “identitet gjinor” përbën një ndërhyrje të thellë ideologjike në këtë ekuilibër, sepse përpiqet të ndryshojë vetë përkufizimin e njeriut dhe të marrëdhënieve familjare në ligj.

Një ndryshim i tillë nuk është thjesht semantik; ai do të hapte një krizë të vërtetë juridike në të gjitha hallkat e sistemit. Në praktikë, ai do të shkaktonte përplasje të drejtpërdrejta midis ligjit të ri dhe Kodit të Familjes, duke ngritur pyetje thelbësore: si do të përcaktohet më martesë, prindërimi, apo trashëgimia? Nëse termi “burrë” dhe “grua” zëvendësohet nga “persona me identitet gjinor” të shumëfishtë apo fluid, a do të nënkuptojë kjo se martesë mund të ndodhë ndërmjet dy identiteteve të vetëdeklaruar, pavarësisht seksit biologjik? A do të thotë kjo se në dokumentet zyrtare fëmijët do të kenë “prind 1” dhe “prind 2”, në vend të “nënë” dhe “baba”?

Kjo do të sillte konfuzion të thellë juridik jo vetëm në regjistrat civilë, por edhe në të drejtën e trashëgimisë, të përgjegjësiave prindërore, të përfitimeve sociale dhe të statistikave shtetërore. Vetë administrata publike do të detyrohej të përdorte terminologji ideologjike në kundërshtim me parimin e neutralitetit shtetëror, i cili është i sanksionuar si parim themelor në jurisprudencën kushtetuese shqiptare dhe evropiane. Shteti nuk mund të përvetësojë doktrina morale apo antropologjike, sepse në atë çast pushon së qeni neutral dhe kthehet në mjet propagandistik të një ideologjie.

Ky devijim do të përplasej edhe me kodet e tjera themelore të Republikës, si Kodi Civil dhe Kodi i Punës, të cilët janë ndërtuar mbi kategoritë biologjike të “mashkullit” dhe “femrës”. Për shembull, në të drejtën e punës, barazia gjinore nënkupton trajtim të drejtë dhe mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, jo për identitete të vetëdeklaruar. Po kështu, në të drejtën civile, çdo përkufizim

që lidhet me martesën, atësinë, amësinë apo kujdestarinë, është ndërtuar mbi biologjinë si fakt juridik dhe jo mbi përceptimin psikologjik të vetëidentitetit.

Në këtë kontekst, filozofi i së drejtës Montesquieu kishte paralajmëruar se “*Ligjet duhet të jenë të përputhshme me natyrën e gjërave*”; pra, nuk mund të krijohen ligje që mohojnë vetë realitetin natyror mbi të cilin mbështeten. Të tentosh të ndërtosh institute juridike, apo institucione, në kundërshtim me ligjet që gjenden në natyrë, është sikur të tentosh të ndërtosh një makinë në kundërshtim me ligjet natyrore të fizikës. Sigurisht që një makineri e tillë që bie ndesh me ligjet universale të natyrës dhe të drejtën natyrore, është e destinuar të dështojë. Ndërsa juristi francez Jean Carbonnier, një nga hartuesit e reformave moderne të së drejtës familjare, theksonte se “*Familja nuk është krijim i ligjit, por njohje e një fakti natyror*.” Pikërisht ky fakt natyror – lidhja midis burrit dhe gruas – është themeli mbi të cilin ngrihet jo vetëm familja, por edhe trashëgimia kulturore, morale dhe biologjike e çdo kombi.

Nëse ligji shqiptar fillon të zëvendësojë biologjinë me ideologji, atëherë ai nuk do të mbrojë më realitetin, por do ta mohojë atë. Ky do të ishte një riformatim artificial i sistemit juridik, që do të kërkonte ndryshime të zinxhirit ligjor në çdo fushë, nga arsimi, te shëndetësia, nga regjistrat civilë te politika sociale, duke e zhytur shtetin në një krizë të re të së drejtës pozitive. Në fund, nuk mund të ketë drejtësi pa të vërtetë, dhe nuk mund të ketë barazi pa realitet. Një ligj që tenton të fshijë fjalët “burrë” dhe “grua” nga kodi themelor i familjes, në thelb, nuk po ndryshon vetëm gjuhën e ligjit, po ndryshon vetë përkufizimin e njeriut.

IV. *Cenimi i lirive themelore: shprehja, media, feja dhe arsimi*

Një nga dimensionet më të rrezikshme të këtij ligji është mënyra se si ai prek vetë themelin e lirive individuale, ato që Kushtetuta, Konventa Evropiane dhe çdo rend demokratik i kanë cilësuar si të paprekshme. Në thelb, kur një ligj nuk kufizon më sjelljet e padrejta, por fillon të kufizojë mendimin vetë, atëherë nuk kemi më mbrojtje nga diskriminimi, por kriminalizim të ndërgjegjes.

a) Liria e shprehjes dhe e medias

Në momentin që nocioni i paqartë “përkatësi e shumëfishtë gjinore” futet në tekst ligjor, çdo diskutim apo kritikë ndaj kësaj teorie mund të interpretohet si “diskriminim”. Kështu, një gazetar që analizon ndikimin e ideologjive gjinore në sistemin arsimor, një pedagog që shpjegon biologjikisht dallimin midis gjinisë dhe seksit, apo një qytetar që mbron vlerat tradicionale të familjes, mund të përfundojë i ndëshkuar për “gjuhë diskriminuese”. Në praktikë, kjo nxit një censurë të heshtur dhe vetëkontroll të frikshëm të fjalës publike, jo për shkak të dhunës, por për shkak të frikës nga ndëshkimi.

Ky është rreziku më i madh për demokracinë: kur qytetarët heshtin jo sepse janë të bindur, por sepse janë të frikësuar. Në fakt, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1976), e ka përkufizuar qartë këtë parim: “*Liria e shprehjes vlen jo vetëm për idetë që priten me miratim, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin apo shqetësojnë shtetin ose një pjesë të shoqërisë. Këto janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendjes së hapur, pa të cilat nuk ka shoqëri demokratike.*”

Pra, ajo që ky ligj bën në realitet është ta zëvendësojë pluralizmin me ortodoksi ideologjike, ku vetëm një mënyrë të menduari dhe të foluri lejohet, dhe çdo mendim tjetër etiketohet si

“diskriminues”. Një shoqëri që fillon të ndëshkojë fjalën e lirë në emër të ndjeshmërisë nuk po ecën drejt drejtësisë, por drejt totalitarizmit.

Në këtë kuptim, ligji shkel drejtpërdrejt nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që garanton lirinë e shprehjes dhe të shtypit, si dhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që mbron të drejtën për të shprehur mendime “pa ndërhyrje nga autoritetet publike”. Siç thekson filozofi John Stuart Mill, *“Nëse mendimi i një njeriu heshtet, bota humbet një të vërtetë të mundshme; nëse mendimi i shumicës bëhet ligj, bota humbet lirinë.”*

Por përtej filozofisë, pasojat janë konkrete: ky ligj vendos një detyrim ligjor për të përdorur gjuhë ideologjike, për shembull, për të përdorur përemra që nuk pasqyrojnë realitetin biologjik. Kështu, një gazetar që refuzon ta bëjë këtë mund të gjobitet; një mësues që shpjegon biologjikisht ndarjen mashkull-femër mund të akuzohet për diskriminim; një prift apo imam që citon tekstet e shenjta për rendin natyror të krijimit mund të përballet me padi civile. Ky është momenti kur ligji ndalon së qenë mbrojtës i lirisë dhe kthehet në armë të frikës, sepse detyron qytetarët të pranojnë një gjuhë që nuk buron nga realiteti, por nga ideologjia. Siç do të thoshte George Orëll, *“Nëse liria do të thotë diçka, ajo është e drejta për t’u thënë njerëzve gjëra që nuk duan t’i dëgjojnë.”* Nëse kjo e drejtë humbet, atëherë nuk kemi më demokraci, por konformitet të detyruar. Dhe një komb që humbet guximin për të thënë të vërtetën, humbet pak nga pak edhe të drejtën për të qenë i lirë.

b) Liria e besimit fetar

Asnjë shoqëri demokratike nuk mund të mbijetojë pa lirinë e ndërgjegjes dhe të besimit. Kjo liri është ndër më të shenjtat, sepse i përket sferës më të thellë të qenies njerëzore, marrëdhënies së njeriut me Zotin dhe me të vërtetën. Për këtë arsye, Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e shpall qartë se *“1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t’i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikën e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.”* Po kështu, Neni 9 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e njeh këtë si një të drejtë themelore, duke theksuar se: *“Çdokush ka të drejtë të ketë dhe të shprehë besimin e tij fetar, individualisht ose kolektivisht, në publik apo privatisht.”*

Mirëpo, ligji i ri e vë në rrezik këtë shtyllë të lirisë. Ai krijon një situatë absurde ku një imam që lexon Kuranin, një prift që predikon Ungjillin, apo një teolog që mbron parimin e krijimit “mashkull e femër”, mund të përballet me padi për “diskriminim gjinor” vetëm pse ka shprehur një doktrinë të besimit të tij. Nëse fjala e shenjtë përkthehet si shkelje ligjore, atëherë nuk kemi më ndarje të shtetit nga feja, kemi ndërhyrje të shtetit në besim. Një situatë e tillë do të përbente cenim të drejtpërdrejtë të rendit kushtetues, sepse e kthen shtetin në gjykatës të dogmës dhe në kontrollues të ndërgjegjes fetare. Siç ka theksuar Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Kokkinakis kundër Greqisë (1993)*, *“Liria e fesë është një nga themelet e një shoqërie demokratike; ajo përbën pasurinë më të çmuar të besimtarëve dhe jo-besimtarëve, sepse garanton pluralizmin që e dallon demokracinë nga totalitarizmi.”*

Nëse një ligj i jep të drejtë shtetit të ndëshkojë fjalën fetare për shkak të përmbajtjes së saj, ai po e shndërron lirinë fetare në liri me leje, një nocion që bie ndesh me çdo standard të së drejtës evropiane dhe ndërkombëtare. Mësimi fetar, predikimi publik dhe doktrina teologjike nuk janë

“diskurs politik” që mund të rregullohet sipas axhendave ideologjike të ditës; ato janë manifestime të ndërgjegjes morale, që duhen mbrojtur pikërisht sepse përbëjnë shtyllën e pluralizmit shoqëror. Në fakt, vetë filozofi Voltaire, i cili ishte kritik i fesë, e mbrojti me forcë të drejtën për ta shprehur atë, duke thënë: *“Unë nuk jam dakord me atë që ti thua, por do të luftoj deri në fund që ti të kesh të drejtën ta thuash.”*. Por me këtë ligj, kjo e drejtë po rrëzohet. Ai rrezikon të bëjë që predikuesit, klerikët dhe studiuesit fetarë të vetëcensurohen nga frika e ndëshkimit, duke heshtur për parimet themelore të besimeve të tyre. Një imam që përmend rendin natyror të krijimit, një prift që citon librin e Zanafillës apo një rabin që flet për ligjin hyjnor, mund të akuzohet për “gjuhë diskriminuese” thjesht sepse flet sipas besimit të vet fetar.

Ky është një rrezik ekzistencial për shoqërinë shqiptare, që historikisht ka qenë model i harmonisë ndërfetare dhe i respektit të ndërsjellë midis feve dhe shtetit. Nëse besimi kthehet në zonë të rrezikshme ligjore, ne nuk humbasim vetëm lirinë fetare – humbasim shpirtin e pluralizmit që ka qenë thelbi i identitetit tonë kombëtar. Sepse, në fund të fundit, siç ka thënë Aleksis de Tocqueville, *“Liria e ndërgjegjes është themeli i çdo lirie tjetër. Kush e shkel atë, shkel të gjitha.”*

c) Liria akademike dhe arsimit

Asnjë shoqëri nuk mund të jetë e lirë nëse arsimit i saj nuk është i lirë. Në momentin që shkolla nuk u mëson më fëmijëve si të mendojnë, por çfarë të mendojnë, ajo ndalon së qenë institucion i dijes dhe kthehet në instrument të ideologjisë. Pikërisht këtë rrezik e sjell futja e termit “edukim gjinor me shumë identitete” në sistemin arsimor shqiptar, një formulim i paqartë që, nën petkun e “barazisë”, rrezikon të zhvendosë arsimin nga shkenca tek doktrina ideologjike.

Nëse ky koncept miratohet në ligj, mësuesit do të detyrohen të mësojnë jo më biologjinë si shkencë, por “ndjesinë personale të gjinisë” si përkufizim i realitetit. Fëmijëve nuk do t’u thuhet më se ekzistojnë dy gjini të përcaktuara biologjikisht, mashkull dhe femër, por se gjinia është “fluide”, “e zgjedhshme” “e shumëfishtë”, dhe “në ndryshim të vazhdueshëm”. Kështu, biologjia do të zëvendësohet nga psikologjia subjektive, dhe edukimi do të humbasë bazën e tij natyrore, shkencore dhe racionale. Siç ka paralajmëruar nobelisti Albert Einstein, *“Edukimi është ajo që mbetet pasi të kesh harruar gjithçka që ke mësuar në shkollë. Por nëse ajo që mëson është e rreme, atëherë edhe ajo që mbetet, është mashtrim.”*.

Ky devijim përbën cenim të hapur të nenit 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që garanton të drejtën e cdo personi për arsimim dhe përcakton se arsimit duhet të synojë zhvillimin e personalitetit dhe dinjitetit njerëzor në përputhje me parimet demokratike. Po ashtu, Protokollin nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 2, i njeh prindërve të drejtën themelore *“për të siguruar që arsimi dhe mësimi i fëmijëve të jetë në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.”*.

Kjo do të thotë se shteti nuk mund t’u imponojë prindërve dhe fëmijëve një doktrinë që bie ndesh me besimin, ndërgjegjen apo bindjet e tyre. Në fakt, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Folgerø kundër Norvegjisë* (2007) vendosi se futja e përmbajtjeve fetare apo filozofike në kurrikulat e detyrueshme, pa mundësinë e shmangies, cenon të drejtën e prindërve për arsim në përputhje me bindjet e tyre. E njëjta logjikë vlen për çdo përmbajtje ideologjike, përfshirë ato mbi identitetet gjinore. Nëse një prind mysliman, i krishterë apo ateist nuk dëshiron që fëmija i tij të mësohet me koncepte që kundërshtojnë biologjinë ose besimin e tij, ai ka të drejtë ligjore ta

kundërshtojë këtë. Arsimi nuk është pronë e shtetit, është e drejtë e qytetarit. Dhe kur shteti shkel këtë të drejtë, ai shkel vetë kontratën themelore të besimit ndërmjet tij dhe shoqërisë.

Në këtë aspekt, liria akademike është një tjetër “viktimë” e qartë e këtij ligji. Profesorët dhe studiuesit që duan të mbrojnë kriteret shkencore të biologjisë ose të debatojnë me mendim kritik ndaj “teorive gjinore” do të jetojnë nën frikën e ndëshkimit disiplinor apo gjobave e padive civile për “diskriminim”. Kështu, universitetet, që duhet të jenë tempulli i debatit të lirë dhe kërkimit të së vërtetës, do të kthehen në hapësira ku e vërteta lejohet vetëm nëse është ideologjikisht e pranueshme. Filozofi Karl Popper, në veprën e tij “Shoqëria e hapur dhe armiqtë e saj”, paralajmëronte: *“Në momentin që ndalojmë diskutimin për një të vërtetë në emër të paqes ideologjike, ne kemi mbyllur rrugën e dijes.”*

Nëse Shqipëria ndjek këtë rrugë, atëherë shkollat e saj nuk do të jenë më vende ku rriten mendje të lira, por ku fëmijët do të trajnohen të mendojnë sipas një modeli të paracaktuar ideologjik. Kjo është e kundërta e arsimit demokratik, është indoktrinim i ligjshëm. Në fund, një shoqëri që lejon që shkencës t’i vendosen kufij ideologjikë, e ka humbur rrugën drejt dijes dhe drejtësisë. Sepse, siç ka thënë filozofi Immanuel Kant, *“Arsimi është drita që ndan njeriun nga injoranca, dhe kush guxon ta errësojë këtë dritë, punon kundër vetë njerëzimit.”*

d) Sporti dhe mjekësia

Ashtu si arsimi, sporti dhe mjekësia janë fusha që prekin vetë thelbin e njeriut, trupin, dinjitetin dhe drejtësinë. Por edhe këto fusha rrezikojnë të deformohen nëse ligji e zëvendëson realitetin biologjik me termin “identitet gjinor”. Në emër të “barazisë”, ai cenon parimin e drejtësisë natyrore në garë dhe sigurisë klinike në shëndetësi, dy shtylla që nuk mund të negociohen në një shoqëri që respekton shkencën dhe jetën njerëzore.

Në sport, përfshirja e meshkujve biologjikë në garat e grave është shembulli më i qartë i padrejtësisë që prodhon një ideologji kur zë vendin e shkencës. Edhe Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) në udhëzimet e vitit 2023 e ka pranuar se pjesëmarrja e atletëve transgjinorë në kategori femërore ngre “pyetje serioze për integritetin e garës dhe barazinë e kushteve të konkurrimit”. Në shumë vende, federatat sportive po rivlerësojnë rregullat e tyre për të ruajtur ekuilibrin midis respektit për individin dhe mbrojtjes së drejtësisë në sport. Sepse sporti është ndërtuar mbi parimin themelor se të gjithë duhet të kenë shanse të barabarta në bazë të kushteve fizike, jo biologjike të ndryshme. Dhe biologjia këtu nuk është paragjykim, por shkencë: fuqia muskulare, densiteti i kockave, kapaciteti kardiovaskular dhe testosteroni ndikojnë në performancë. Injorimi i këtyre faktorëve në emër të “identitetit” përbën një padrejtësi ndaj grave që kanë luftuar për dekada për të fituar hapësirën e tyre të barabartë në sport. Siç ka thënë filozofi i së drejtës Ronald Dëorkin, *“Barazia nuk qëndron në trajtimin identik, por në respektin ndaj dallimeve reale.”*

Në mjekësi, pasojat janë edhe më të rënda, sepse këtu nuk preket vetëm drejtësia, por jeta vetë. Detyrimi i mjekëve që të trajtojnë pacientët jo sipas gjinisë biologjike, por sipas “identitetit të deklaruar”, mund të sjellë pasoja fatale. Diagnozot, medikamentet, terapitë hormonale dhe operacionet varen nga realiteti biologjik, jo nga ndjesia individuale. Nëse një mjek detyrohet ligjërisht të injorojë biologjinë për t’u përshtatur me një kategori ideologjike, ai jo vetëm humbet lirinë profesionale, por edhe përballlet me rrezik penal, administrative, civil dhe etik. Në fakt, shumë shoqata mjekësore ndërkombëtare kanë ngritur alarmin për këtë devijim. Raporti i Cass Revieë (UK, 2024), një studim i pavarur për trajtimin e të miturve me disfori gjinore, paralajmëron

se “vendimet mjekësore nuk mund të bazohen në ideologji, por në prova shkencore dhe kujdes klinik të kujdesshëm”. Ky është një parim që mbrohet edhe nga Deklarata Universale për Bioetikën dhe të Drejtat e Njeriut (UNESCO, 2005), e cila thekson se dinjteti njerëzor dhe siguria shëndetësore duhet të mbizotërojnë mbi çdo presion politik apo ideologjik.

Në këtë kuptim, neni 55 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e çdo personi për t’u mbrojtur nga trajtimet që rrezikojnë jetën, shëndetin ose integritetin fizik e moral. Nëse një ligj detyron mjekët të ndjekin kategori ideologjike në vend të diagnozës shkencore, ai bie ndesh me këtë nen dhe me parimet themelore të etikës mjekësore, përfshirë parimin e mosdëmtimit (*primum non nocere*) dhe parimin e kompetencës profesionale. Në të vërtetë, këtu qëndron edhe paradoksi më i madh i këtij ligji: në përpjekje për të mbrojtur një “identitet”, ai rrezikon trupin real të njeriut. Në sport, ai shkel barazinë; në mjekësi, ai rrezikon jetën. Dhe, siç ka thënë mjeku dhe filozofi francez Alexis Carrel, “*Shoqëritë që mohojnë biologjinë e njeriut nuk bëhen më humane, bëhen më të rreme.*”

Prandaj, një shtet që kërkon të quhet demokratik duhet të mbrojë të vërtetën e trupit dhe drejtësinë e garës, jo ta shkatërrojë ato në emër të ideologjisë. Sepse në fund, siç na kujton Aristoteli, “*Drejtësia është përpjekja për t’i dhënë secilit atë që i takon.*” Nëse një vajzë humbet medaljen e saj përballë një konkurenti biologjikisht mashkull, apo një pacient humbet shëndetin sepse mjeku i tij u detyrua të trajtojë “identitetin” e jo trupin, atëherë drejtësia është shkelur, dhe me të, edhe vetë njeriu.

V. Përmbysja e prezumimit të pafajësisë

Një nga goditjet më të rënda që ky ligj i jep shtetit të së drejtës është përmbysja e parimit të prezumimit të pafajësisë, një nga themelët e çdo sistemi juridik demokratik. Në thelb, ai vendos një logjikë të përmbysur: jo më “i pafajshëm derisa të provohet fajësia”, por “i fajshëm derisa të arrish të vërtetosh pafajësinë”. Kjo qasje, e fshehur pas gjuhës së “mbrojtjes nga diskriminimi”, përbën një nga precedentët më të rrezikshëm në historinë ligjore të Shqipërisë.

Në fakt, parimi i prezumimit të pafajësisë nuk është ekskluzivisht penal, ai shtrihet si një parim i përgjithshëm i rendit juridik, i pranuar edhe në të drejtën administrative dhe civile. Ky është një nga themelet që e dallon shtetin e së drejtës nga regjimet ideologjike, sepse ai mbron qytetarin nga arbitrariteti i pushtetit dhe nga akuzat pa prova.

Në rastet e akuzave për “diskriminim gjinor” apo “përkatësi të shumëfishtë”, ligji ngarkon të akuzuarin me barrën e provës, duke e detyruar të mbrojë veten përballë një perceptimi subjektiv. Me fjalë të tjera, mjafton që një person të ndjehet “i ofenduar” për shkak të një mendimi apo deklarate, që tjetri të detyrohet të provojë se nuk ka diskriminuar. Kjo është një drejtësi e përmbysur, ku ndjesia personale e paditësit zëvendëson provën faktike.

Në të drejtën administrative, ky parim zbatohet qartë në procedurat e gjobave dhe sanksioneve administrative. Vetë Kodi i Procedurave Administrative parashikon se administrata publike duhet të bazohet mbi parimin e ligjshmërisë dhe të provueshmërisë. Çdo masë ndëshkimore administrative, përfshirë gjobat, kërkon prova të qarta dhe të verifikueshme që vërtetojnë shkeljen nga subjekti. Administrata nuk mund të ndëshkojë mbi bazën e supozimeve, ndjesive apo interpretimeve ideologjike. Po ashtu, Neni 82 i të njëjtit Kod përcakton qartë se barrën e provës për ligjshmërinë e aktit e mban organi administrativ që e ka nxjerrë atë.

Kjo do të thotë se, në çdo rast gjobe apo mase disiplinore, nuk është qytetari ai që duhet të provojë pafajësinë e vet, por administrata që duhet të provojë shkeljen. Ky është një parim i pandashëm nga siguria juridike, çdo përmbysje e tij e kthen ligjin në instrument represioni.

Edhe në të drejtën civile, barrën e provës e mban gjithmonë pala që pretendon cenimin ose dëmin. Ky parim themelor përcaktohet në Nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ku thuhet: *“Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj”*. Kështu, nëse një person pretendon se është diskriminuar apo është ndjerë “i dëmtuar moralisht”, ai duhet të sjellë prova konkrete që vërtetojnë faktin e diskriminimit dhe lidhjen shkakësore midis fjalës apo veprimit dhe dëmit të pësuar. Vetëm pas një verifikimi objektiv mund të vendoset përgjegjësia civile. Përndryshe, sistemi do të lejonte që çdo ndjesi subjektive të kthehej në armë ligjore kundër lirisë së tjetrit.

Në praktikë, kjo do të thotë se një mësues që shpjegon biologjinë sipas kriterëve shkencorë, një gazetar që shpreh opinion kritik ndaj teorive gjinore, apo një prift që citon librin e tij të shenjtë, mund të përfundojë në proces gjyqësor vetëm sepse dikush është “ndjerë i diskriminuar”. Dhe në vend që gjykata të kërkojë prova për ekzistencën e diskriminimit, ajo do të kërkojë prova për mungesën e tij, një absurditet juridik që e kthen barrën e mbrojtjes në dënim në vetvete.

Një drejtësi e tillë nuk mbron barazinë, por instalon frikën. Sepse çdo profesionist, qytetar apo besimtar do të mendojë dy herë përpara se të flasë, jo nga respekti për tjetrin, por nga frika se mund të ndëshkohet për mendimin e tij. Dhe një shoqëri që jeton nën frikën e mendimit të lirë nuk është më shoqëri e lirë, është shtet ideologjik. Në fund të fundit, ky ligj i propozuar nuk është një hap përpara drejt drejtësisë, por një kthim pas drejt logjikës së inkuzicionit, ku mendimi i ndryshëm trajtohet si faj dhe heshtja si mbrojtje. Dhe Shqipëria nuk mund të ndërtojë një shoqëri të lirë mbi themele të padrejtësisë.

Z. President,

Asnjë shoqëri nuk bëhet më e drejtë duke ndaluar mendimin. Asnjë ligj nuk mund të mbrojtë lirinë duke e shkatërruar atë. Dhe asnjë shtet nuk bëhet më evropian duke imituar keq Evropën, apo duke përdorur emrin e saj për të justifikuar imponimin e një ideologjie që shumë vende të Bashkimit Europian tashmë e kanë refuzuar me vendosmëri.

Ky ligj, që paraqitet si “për barazinë gjinore” dhe si “detyrim i përafrimit me legjislacionin e BE-së”, në fakt është një produkt i keqkuptuar ideologjikisht dhe i rrezikshëm juridikisht. Ai nuk është as përafrim, as progres, por një devijim nga rendi kushtetues, nga parimet themelore të drejtësisë dhe nga identiteti natyror i njeriut.

Në thelb, ai nuk mbron askënd nga diskriminimi real, por krijon mekanizma të rinj për të ndëshkuar mendimin, për të imponuar gjuhën, për të kontrolluar arsimin, për të heshtur besimin dhe për të riformatuar vetë konceptin e njeriut. Ai e kthen shtetin nga garant i lirive në arbitër të mendimeve, nga mbrojtës i të drejtave, në prodhues frike.

Nga pikëpamja kushtetuese, ligji bie ndesh me nenet themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në planin evropian, ky ligj është një mashtrim publik. Asnjë direktivë e Bashkimit Europian, nuk përmend “identitetin gjinor”, “përkatësi të shumëfishtë” apo “transgjinorë” si kategori

ligjore. Të gjitha këto direktiva flasin për barazi midis burrave dhe grave, jo midis perceptimeve. Edhe Gjykata e Drejtësisë së BE-së, e ka theksuar qartë se përcaktimi i kushteve për njohjen e gjinisë është kompetencë e shteteve anëtare, jo detyrim komunitar. Prandaj, të thuash se ky ligj “na e kërkon Europa” është një gënjeshtëri e qëllimshme, që synon të mashtrojë publikun, deputetët dhe vetë shoqërinë shqiptare.

Nëse ky ligj hynë në fuqi, Kuvendi i Shqipërisë do të hyjë në histori jo si mbrojtës i drejtësisë, por si ai që hapi portën e censurës ligjore në emër të “tolerancës”. Do të jetë ligji që nuk solli barazi, por frikë; nuk mbrojt njeriun, por ideologjinë; nuk afroi Shqipërinë me Europën, por e largoi nga vetvetja.

Prandaj, ju Z. President jeni përpara një prove historike: A do të mbroni parimet e Kushtetutës, të arsyes dhe të lirisë, apo do të dorëzoheni para imponimit të ideologjisë? A do të qëndroni në themelin e së drejtës, apo do të rrëshqisni në autoritarizëm ideologjik të pakeluar si “tolerancë”?

Zgjidhja është e qartë: Termat “përkatësi e shumëfishtë gjinore” dhe “identitet gjinor” duhet të hiqen plotësisht nga ligji. Barazia duhet të mbetet ajo që është, barazi midis burrit dhe gruas, jo midis ndjesive. Liritë themelore, e shprehjes, e fesë, e medias, e arsimit dhe e ndërgjegjes, duhet të ruhen si gurët themelorë të Republikës.

Nëse ju lejoni hyrjen në fuqi të këtij ligji, atëherë Shqipëria do të bëhet laborator i parë i një ideologjie që vetë Europa po e braktis, dhe historia do ta kujtojë këtë moment jo si çast emancipimi, por si çastin kur një komb i vogël guxoi të shkelte me ligj vetë arsyen njerëzore. Sic bëri në vitin e mbrapshtë 1976 që instaloj në Kushtetutë diktaturën e vetme ideologjike ateisto-komuniste në historinë kushtetutese të shteteve moderne. Dhe pasojat, dihen z. President.

Për këtë arsye, ju kërkojmë që të paktën një herë të vetme gjatë ushtrimit të detyrës tuaj si President i Republikës, të ngriheni në lartësinë e detyrës, të ndaloni përcarjen, deformimin, denaturimin, dhe të ndiqni edhe këshillat e komuniteteve fetare, për të ruajtur tradidën shqiptare se asnjë rregull në shoqërinë tonë nuk mund të imponohet në kundërshti me përfaqësuesit e komuniteteve fetare. Për të gjitha sa më lart,

KËRKOJMË:

Të riktheni për rishqyrtim në Kuvend ligjin “Për barazinë gjinore”, sipas kompetencës që ju njeh Kushtetuta në nenin 85 të saj.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETET E OPOZITËS:

1. Albane Valshe

3. Manjola Dukaj
5. Ledina Alolli

2. Elda Hati

4. Denisa Vata
6. Jozefina Topelli
7. Klodiana Legj

- 8) Zets Benderi Z
- 9) Ina Zhupa 
- 10) Brnilda Haxhi Rana 
- 11) ERISA XHIXHO 
- 12) Jasele Tebelu 